

VENDIM
Nr. 721, datë 5.12.2018

PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË BILETAVE TË TEATRIT KOMBËTAR DHE TEATRIT KOMBËTAR EKSPERIMENTAL “KUJTIM SPAHIVOGLI”
(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 1.6.2022)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Miratimin e tarifës së biletave për Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, sipas tabelës në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1/1. Tarifat e reduktuara të jenë sipas çmimit të përcaktuar në tabelën e shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Të ardhurat e realizuara nga shitja e biletave do të përdoren: 30% për llogari të Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, sipas limitit të përcaktuar në planin e shpenzimeve, dhe 70% do të derdhen në buxhetin e shtetit.

3. Në asnjë rast, këto të ardhura nuk do të përdoren për shpërblimin e punonjësve.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Teatri Kombëtar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

ÇMIMET E BILETAVE PËR TEATRIN KOMBËTAR DHE TEATRIN KOMBËTAR EKSPERIMENTAL “KUJTIM SPAHIVOGLI”

Nr.	Kategoria e biletës	Çmimi
1	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	300 lekë
2	Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	500 lekë

SHTOJCA NR. 2

(shtuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 1.6.2022)

Nr.	Kategoria sociale	Kategoria e biletës	Çmimi
1	Studentët	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	150 lekë/bileta
		Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	250 lekë/bileta
		Për shfaqje artistike në kuadër të edukimit përmes kulturës	Pa tarifë
2	Personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	150 lekë/bileta
		Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	250 lekë/bileta

3	Jetimët	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	150 lekë/bileta
		Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	250 lekë/bileta
4	Të verbrit	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	Pa tarifë
		Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	Pa tarifë
5	Fëmijët nën 18 vjeç	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	150 lekë/bileta
		Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	250 lekë/bileta
6	Invalidët e punës	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	150 lekë/bileta
		Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	250 lekë/bileta
7	Personat me aftësi të kufizuara fizike, mendore, shqisore dhe personat që nuk dëgjojnë	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	150 lekë/bileta
		Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	250 lekë/bileta
8	Nënat kryefamiljare me të ardhura të ulëta	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	150 lekë/bileta
		Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	250 lekë/bileta
9	Familjet përfituese të ndihmës ekonomike	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	150 lekë/bileta
		Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	250 lekë/bileta
10	Fëmijët të cilëve u është dhënë statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	150 lekë/bileta
		Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	250 lekë/bileta
11	Personat që u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	150 lekë/bileta
		Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	250 lekë/bileta